

BULETIN INFORMATIV**Tryezë Diskutimi: “Dhuna dhe Seksizmi ndaj Grave e Vajzave në Politikë”**

Tiranë, më 26.4.2023. Të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm për ekzistencën e dhunës dhe seksizmit ndaj grave dhe vajzave në politikë. Për të diskutuar në lidhje me këtë temë, [Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"](#) dhe [Fondacioni Westminster për Demokraci](#) kanë organizuar një tryezë diskutimi me pjesëmarrjen e grave e vajzave nga politika shqiptare dhe nga shoqëria civile..

Diskutimi u përqendrua në të drejtat e njeriut të grave dhe vajzave që vendosin të marrin pjesë si anëtare në partitë politike, apo të kandidojnë në pozicione të ndryshme brenda partisë apo gjatë proceseve zgjedhore. Problematika e dhunës dhe seksizmit në këto raste ndikon në performancën e tyre dhe në avancimin e tyre në skenën politike dhe publike.

Gjatë kësaj tryeze diskutimi u theksua rëndësia e kësaj çështjeje, sidomos në kontekstin e fushatës elektorale të zgjedhjeve vendore të 14 majit, 2023. Në takim u prezantua faqja e internetit <https://stopvawp.al/> si platforma për denoncimin e dhunës ndaj grave në politikë, e cila ofron mekanizmat e nevojshëm për të denoncuar dhunën ndaj grave në politikë, duke përfshirë formularin anonim online dhe numrin pa pagesë **08001818**.

Znj. Mirela Arqimandriti – Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim theksoi se çështja e dhunës ndaj grave në politikë (DhGR) pothuajse mungon plotësisht në diskursin publik në Shqipëri. Fenomeni nuk njihet, nuk flitet dhe injorohet në dokumentet kryesore të politikave dhe proceset vendimmarrëse. Ndërsa dhuna me bazë gjinore dhe në familje është e dokumentuar mirë dhe i kushtohet vëmendje, prevalenca e një dhune të tillë në sferën politike duket se është në fund të listës së prioriteteve. Si pikënisje, ka mungesë të përcaktimeve të qarta se çfarë përbën dhunë ndaj grave në politikë dhe vendimmarrje. Prandaj, ndërkohë që dhuna ndaj grave është e përfshirë në legjislacionin kombëtar dhe kriminalizohet, nuk ka një përkufizim të dhunës ndaj grave e vajzave në politikë (DhGP) dhe formave të ndryshme të saj. Gjithashtu në statutet e partive politike apo në forumet politike të grave, mungon përkufizimi i DhGP. Ndaj do të ishte me shumë rëndësi nëse çdo parti do të sanksionojë në statutin e vet mbrojtjen e grave në politikë ndaj dhunës. Hap i rëndësishëm do të ishte krijimi i një mekanizmi në parlamentin shqiptar për të raportuar këtë lloj dhune.

Në vijim **znj. Alkida Lushaj**, Menaxhere e Programit pranë Fondacionit Westminster për Demokraci prezantoi përpjekjet e Fondacionit për të mbështetur konsolidimin e demokracisë dhe fuqizimin e gruas në vendimmarrje dhe politikë. Në Shqipëri, megjithëse ka pasur suksese në barazinë gjinore në legjislacion dhe rregulla, gratë ende vuajnë nga kostot e larta të fushatës dhe qasja patriarkale në politikë, duke i paraqitur burrat si më dominues dhe influencues në politikë, financat politike, lokale etj. *“Duhet kuptuar që dhuna në politikë, duke filluar nga gjuha e urrejtjes, dhuna verbale, kërcënimet apo ngacmimet seksuale etj., sjell pasoja jashtëzakonisht të dëmshme dhe negative për jetësimin e një demokracie të shëndetshme por gjithashtu edhe për zhvillimin e vendit”* – tha znj. Lushaj.

Znj. Oriola Pampuri, anëtare e Kuvendit të Shqipërisë dhe anëtare e Partisë Demokratike Shqiptare, u shpreh se në politikën shqiptare vazhdon të ketë tronditje për shkak të dhunës dhe shpifjeve kundër grave e vajzave në politikë. Gruaja në politikë vazhdon të përballlet me diskriminim dhe stereotipe. Megjithatë, gratë që marrin pjesë në politikë janë të kualifikuara dhe kanë një mision të rëndësishëm në jetën publike. Ato kanë punuar shumë dhe kanë studiuar që të japin kontributin e tyre. Sidoqoftë, kur një grua futet në politikë, shpesh përballlet me shpifje dhe kritika të pafundme nga rrjetet sociale dhe mediat. Kjo kërkon një ndryshim kulturor dhe ligjor në Shqipëri, për të ndaluar shpifjet dhe dhunën në politikë, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rolin e rëndësishëm të grave në jetën publike. *“Është një nismë që duhet të nisë sot dhe të kalojë disa hapa të rëndësishëm, që nga forcimi i ligjit, përfshirja, serioziteti i të gjithë aktorëve.”* – tha znj. Pampuri.

Në këtë takim mori pjesë edhe **znj. Erisa Xhixho**, anëtare e Partisë së Lirisë e cila theksoi se kur gratë në politikë linçohen, fenomeni nuk i prek vetëm ato por edhe vajzat dhe gratë e tjera që duan të hyjnë në politikë. Kjo i bën të ndjehen të demotivuara dhe të mendojnë se politika është një fushë e burrave dhe shumë e vështirë për t'u përfshirë. Është me rëndësi që në këtë moment të jemi të bashkuara dhe të mbrojmë njëra-tjetrën, duke i dhënë një mesazh të fortë se asnjë grua nuk duhet të vuajë dhunën verbale në politikë. Në këtë mënyrë, mund të ndërtojmë një kulturë politike më të ndjeshme dhe të respektojmë të drejtat e grave në politikë. *“Vetëm duke qenë bashkë në këtë betejë kundër dhunës ndaj grave që merren me politikë dhe duke i përfshirë gratë dhe vajzat në mënyrë aktive në vendimmarrje, do ta bëjmë më të mirë shoqërinë.”* – e përmbylli fjalën e saj znj. Xhixho.

Znj. Edlira Çepani, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti i Grave “Barazi në Vendimmarrje” theksoi nevojën e mbështetjes së vajzave dhe grave në politikë, si dhe për problematikën e dhunës me bazë gjinore që mund të hasin ato. Edhe pse shpesh konsiderohet si një kosto për tu marrë me politikë, dhuna nuk duhet të tolerohet në asnjë ambient, duke përfshirë edhe politikën. Një nga problemet në lidhje me dhunën është raportimi, i cili nuk ndodh shpesh për shkak të konsideratave të brendshme të partive politike. *“Ndër rekomandimet, unë do të përmendja vetëm tre – tha znj. Çepani: Përmendja në statutet e partive, që nuk ekziston. Duhet të krijohet një kod dhe protokoll brenda partisë për të reaguar ndaj dhunës, i firmosur nga lidhshipi. Dhe patjetër që nevojitet edhe ndërgjegjësimi për nevojën e raportimit dhe të reagimit në këto raste, si nga gratë në politikë, ashtu edhe shoqëria civile dhe mediat, duke bërë një bashkësi e cila nuk hesht për dhunën.”*

Znj. Ana Kadovic nga National Democratic Institute (NDI) në Shqipëri theksoi rëndësinë e luftimit kundër dhunës me bazë gjinore në politikë dhe në shoqëri në tërësi. Për të adresuar këtë problem, është e nevojshme puna më intensive me burrat dhe krijimi i aleancave me ta. Në këtë drejtim, egzistojnë nisma për ndryshimin e kodit zgjedhor për të siguruar akses të barabartë për gratë dhe burrat në burime financiare. Në të njëjtën kohë, shtrëngimi ekonomik dhe mungesa e aksesit në burime financiare janë identifikuar si një formë dhune ndaj grave në politikë, duke i shtyrë ato të heshtin për rastet e dhunës. Prandaj, është e nevojshme për gratë dhe burrat të bashkojnë forcat për të luftuar këtë fenomen dhe për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore në politikë.

Ndër të tjera znj. Kovacevic tha: *“Do të doja të citoja Kryetaren e ndjerë të Bordit të NDI, znj. Albright, e cila pati theksuar se, në qoftë se nuk eliminojmë dhunën ndaj grave në politikë, nuk mund të presim të eliminojmë dhunën me bazë gjinore. Pra kjo është një nga mënyrat se si ta adresojmë këtë problem në mënyrë më të përgjegjshme.”*

Znj. Kriselda Dedndreaj nga Qëndresa Qytetare theksoi se gratë në politikë ballafaqohen me tre forma të ndryshme të dhunës: dhunën në shoqëri, dhunën nga partitë politike dhe dhunën nga media. Ajo u shpreh se është e vështirë për gratë të përfaqësohen në politikë, pasi janë shumë të ekspozuara dhe viktimizohen lehtësisht nga këto forma të dhunës. Ndër të tjera znj. Dedndreaj solli në vëmendje se kur kërkon në internet për gratë në politikë, gjen se figura e një femre shpesh seksualizohet dhe skandale shpifëse bëhen të njohura, duke e bërë më të vështirë për gratë të përfaqësohen në politikë. *“Shpresoj që kjo nismë të ketë një vazhdimësi. Shpresoj të bëhet burim për ndjekje dhe krijim rrjetesh të grave të cilat flasin për problemet e tyre por në të njëjtën kohë edhe gjejnë zgjidhje.”* – e mbylli fjalën e saj znj. Dedndreaj.

Në mbyllje të aktivitetit znj. Mirela Arqimandriti listoi konkluzionet e dala nga konferenca:

- Shpifja dhe lajmet e rreme (fake news) duhet të adresohen menjëherë;
- Të organizohemi në një grup bashkë gra e burra në politikë, shoqëri civile dhe media dhe të reagojmë menjëherë për çdo cënim dinjiteti të një gruaje në politikë;
- Duhet organizuar më shumë fushata ndërgjegjësuese dhe informuese;
- Angazhimi i të gjithëve për vënien në punë të mekanizmit për raportimin e dhunës ndaj grave në politikë dhe ky mekanizëm të ankorohet në një institucion të rëndësishëm siç është Parlamenti i Shqipërisë.

Për të ndjekur takimin e plotë ju lutemi të klikoni [këtu](#)

Për të raportuar në mënyrë anonime online ju lutemi të klikoni [këtu](#)

Për të raportuar nëpërmjet telefonit, ju lutemi të telefononi në numrin jeshil pa pagesë: **0800 18 18**

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Tel: +355 4 22 555 14

Email: gadc@gadc.org.al

Web: <https://gadc.org.al/>